



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nr *31* Prot

Datë *01/07* 2019

QENDRËS SHQIPTARE MEDIA LOOK

Bazuar në kërkesën tuaj për informacion lidhur me masat e marra për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet ju formojmë si më poshtë:

Në zbatim ligjit nr 18/2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është miratuar VKM Nr. 465, datë 3.7.2019 “Për Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet” që përcakton masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme dhe/ose të paligjshme në internet. Bazuar në këtë VKM është në proces hartimi dhe miratimi Udhëzimi “Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe /ose të dëmshme për moshën e tij”. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat përkatëse si dhe të garantojë mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme dhe /ose të paligjshme në internet në mjediset e institucioneve arsimore.

VKM e mësipërme ka parashikuar gjithashtu që fëmijët nën moshën 14 vjeç do të frekuentojnë subjektet tregtare, të shërbimit të internetit vetëm të shoqëruar nga prindi, kujdestari i fëmijës apo i afërmi, i cili nënshkruan një formular tip, që përcaktohet nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF). Përgatitja dhe shpërndarja e formularit është në proces.

Bazuar në nenin 27/3 të ligjit nr 18/2017 dhe në VKM Nr. 465, datë 3.7.2019 “Për Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”, ASHMDF shqyrton çdo raportim për çdo rast të konstatuar lidhur me faqe/materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet.

Në bashkëpunim dhe me marrëveshje bashkëpunimi me Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë ALO 116 111, është vendosur në dispozicion një linjë telefonike falas për fëmijët dhe publikun, me qëllim raportimin e materialeve të dëmshme ose të paligjshme për fëmijët në internet apo rasteve të abuzimit me fëmijët.

Në total, për 2019, janë 23 raste të abuzimit apo bullizmit online të fëmijëve, në formën e videove që qarkullojnë në rrjete sociale (instagram, youtube, facebook). Rastet janë identifikuar/raportuar nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), Alo 116111 si dhe janë identifikuar nga ASHDMF nëpërmjet monitorimit të përditshëm të mediave. Rastet janë referuar pranë strukturave të policisë, krimin kibernetik, për hetimin, identifikimin e autorëve dhe bllokimin e faqeve.

Rastet kur është identifikuar fëmija i abuzuar janë referuar për menaxhim tek NJMF.

Problematika janë shfaqur edhe gjatë raportimit nga mediat të lajmeve që kanë të bëjnë me fëmijët. Lajmet të cilat kishin përmbajtje të dëmshme ose raportin lajmin në mënyrë të papërshtatshme për fëmijën, janë referuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjatë 2019 janë identifikuar 7 lajme të tilla. Në përgjithësi mediat kanë reaguar duke e fshirë lajmin e papërshtatshëm.

Gjithashtu ASHDMF ka realizuar takime sensibilizuese me aktorë nga fusha e medias lidhur me për respektimin e të drejtave të fëmijëve në media dhe respektimin e privatësisë së tyre nga mediat.

Për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital, ASHDMF bashkëpunon me organizma ndërkombëtare dhe kombëtare, siç janë Këshilli i Europës, UNICEF, CRCA, Linja e Këshillimit ALO 116111, me synim rritjen e bashkëpunimit për parandalimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve gjatë përdorimit të internetit si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve, prindërve, profesionistëve për trajtimin e këtyre rasteve.

Aktualisht, ASHDMF është duke zbatuar një projekt me Këshillin e Europës “Ndal shfrytëzimin dhe abuzimin seksual online të fëmijës” së bashku me 10 shtete anëtare të Këshillit të Europës ku është përfshirë dhe Shqipëria. Ky projekt ka qëllim mbështetjen e përpjekjeve dhe veprimeve të vendeve anëtare për parandalimin, ndalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijës si dhe për të fuqizuar fëmijët për të ushtruar të drejtat e tyre në një mënyrë të sigurt në mjedisin digjital.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Alma Tandili

Në mungesë dhe me porosi

Arda Hoxha
Përgjegjëse sektori

